

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9573, DATË 3.7.2006, “PËR AUTORIPARIMIN, SHITBLERJEN, DEPOZITIMIN E MJETEVE RRUGORE ME MOTOR, TË RIMORKIOVE DHE PJESËVE TË TYRE TË DALA JASHTË PËRDORIMIT OSE TË BRAKTISURA DHE PËR VEPRIMTARITË QË LIDHEN ME TO”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Në kuadër të reformës së deregullimit dhe me qëllim krijimin e lehtësirave të mëtejshme për përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet reduktimit të barrierave administrative, janë analizuar të gjitha licencat dhe lejet e përfshira në anekset 1 dhe 2, të vendimit nr.538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga ose nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

Në përfundim të analizës, ndër të tjera, u arrit në konkluzionin se 23 licenca eliminohen.

Me anë të këtyre ndryshimeve synohet të arrihet:

- a) reduktimi i barrierave administrative;
- b) liberalizimi i tregut;
- c) përmirësimi i mëtejshëm i klimës së biznesit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj nuk është i planifikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Neni 5, i ligjit nr.10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikon se “Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, si rregull, kushtet e përgjithshme të licencimit, autorizimit dhe lejimit, organi kompetent që vlerëson përmbushjen e këtyre kushteve, organi kompetent për inspektimin dhe/ose për revokimin e licencës, autorizimit dhe lejes, si dhe shkaqet e revokimit përcaktohen me ligj, ndërsa kushtet e posaçme të licencimit, të autorizimit dhe lejimit, dokumentet shoqëruese, që paraqiten për pajisjen me licencë, autorizim apo leje, afati i vlefshmërisë së licencës, të autorizimit dhe lejes, procedurat e shqyrtimit dhe të vendimmarrjes dhe afatet për kryerjen e tyre, si dhe procedurat e revokimit miratohen me akt nënligjor, në bazë dhe në zbatim të këtij ligji dhe të ligjit që e parashikon atë licencë, autorizim apo leje.”.

Për sa më sipër, me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencave “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.3, “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuara nga prodhuesi”, me kodin VII.3.B.3, “Agjenci që trajtojnë praktikatat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4. Me shfuqizimin e këtyre licencave, ushtrimi i veprimtarive të tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove; tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuara nga prodhuesi dhe agjencive që trajtojnë praktikatat e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove do të jenë të lira.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se tashmë ushtrimi i veprimtarisë së një agjencie kryhet nga subjekte në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Subjektet duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar si objekt të veprimtarisë së tyre trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor. Gjithashtu, ushtrimi i veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuara nga prodhuesi i tyre, kryhet nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e këtyre veprimtarive.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk ka për qëllim përafrimin me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Me anë të këtij projektligji propozohet shfuqizimi i licencave “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.3, “Tregtimi i pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi”, me kodin VII.3.B.3, dhe “Agjenci që trajtojnë praktikën e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove”, me kodin VII.3.B.4. Me shfuqizimin e këtyre licencave, ushtrimi i veprimtarive të tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe/ose të rimorkiove; tregtimit të pjesëve të këmbimit të mjeteve rrugore me motor dhe ose të rimorkiove të autorizuar nga prodhuesi dhe agjencive që trajtojnë praktikën e qarkullimit të mjeteve me motor dhe/ose të rimorkiove do të jenë të lira.

Ndërkohë, ky projektligj parashikon se tashmë ushtrimi i veprimtarisë së një agjencie kryhet nga subjekte në përputhje me dispozitat e këtij ligji. Subjektet duhet të kenë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, trajtimin e praktikave të qarkullimit të mjeteve me motor. Gjithashtu, ushtrimi i veprimtarisë së shitblerjes, të ndërmjetësimit, të autoriparimit për mjetet rrugore me motor dhe rimorkiot, të autorizuar nga prodhuesi i tyre, kryhet nga subjektet juridike, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe që kanë të regjistruar në regjistrin tregtar, si objekt të veprimtarisë së tyre, ushtrimin e këtyre veprimtarive.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për marrjen e masave për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat përkatëse teknike të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj nuk ka efekte financiare.

KËSHILLI I MINISTRAVE